



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN sha**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 1
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

[03.04.2023]

Drejtuar: KASTRATI shpk, me adresë: Durrës, Lagjja 14, Rruga: Tirana, pranë Gjykatës së Apelit Shkozet.

Procedura e prokurimit/lotit “Blerje Karburanti”/ Loti II: Blerje Benzine

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Me nr. REF: 61181-03-02-2023, e ndarë në dy Lote,

Loti II: me nr. REF: 61190-03-02-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Procedurë e hapur-mallra**, me objekt **“Blerje Karburanti”**, e ndarë në dy Lote.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Buletini i Njoftimeve Publike, dt. 06. 03. 2023, nr. 21.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “Olsi” shpk

Emri i plotë i shoqërisë

J63423463I

Numri i NIPT-t

Vlera:

Loti II: 397,890.2 (treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë pik dy) lekë **pa TVSH**, me marsh fitimi 17 lekë

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. KASTRATI shpk

Emri i plotë i shoqërisë

J61813529P

Numri i NIPT-it

¹ Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

Vlera:

Loti II: 402,500 (katërqind e dy mijë e pesëqind) lek **pa TVSH**, me marzh fitimi 17 lekë.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“Olsi” shpk**

J63423463I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet e mëposhtme

Për arsye të mangësive në disa prej dokumenteve të paraqitura në procedurën e këtij prokurimi. OE **nuk përmbush kriteret e mëposhtme:**

Në pikën 2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 ose ekuivalentë të vlefshëm që i referohet objektit të prokurimit. OE “Olsi” shpk, ka paraqitur certifikate ISO 9001-2015 certifikuar nga TUV-Nord me nr 44 100 19 32 0283 e **vlefshme deri më 2022-12-16. Përsa më sipër certifikata nuk konsiderohet e vlefshme pasi ka kaluar afatin e vlefshmërisë. Kriteri konsiderohet i pa përmbushur.**

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 14001 ose ekuivalente të vlefshme, të Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet. OE “Olsi” shpk, ka paraqitur certifikate ISO 14001 certifikuar nga TUV-Nord me nr 44 104 19 32 0283 e **vlefshme deri më 2022-12-16. Përsa më sipër certifikata nuk konsiderohet e vlefshme pasi ka kaluar afatin e vlefshmërisë. Kriteri konsiderohet i pa përmbushur.**

2.3.5 Për arsye të specifikës të punës së shoqërisë dhe lëvizjeve të shpeshta që kryhen në gjithë rajonin, subjekti ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor më poshtë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë qiraje ose akt pronësie ose të kenë kontratë furnizimi (bashkëpunimi), ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB.

Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhen të jenë të pajisur me:

- Licensë lëshuar nga pushteti vendor,
- Leje mjedisore të tipit B, lëshuar nga QKL,
- Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK),
- Certifikatë të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)
- Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë në datën e hapjes së ofertave.

Kërkohet të ketë minimumi nga 1 (Një) Stacion tregtimi të karburanteve në çdo nga qytetet Gramsh, Librazhd, Peqin, Elbasan, Cërrik-Belsh, brenda kufirit territorial të çdo qyteti të sipërpërmendur.

- Operatori Ekonomik duhet të deklarojë që stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve ku do të kryhet furnizimi, të cilët janë në marrëveshje me të tretë (kontrata furnizimi/bashkëpunimi), të lidhur për këtë qëllim me shoqëri të tjera, e cila duhet të garantojë përmbushjen e të gjitha kriterëve të vendosura në dokumentet e tenderit, si dhe detyrimisht të jenë të pajisura me Sistem Elektronik.

OE "Olsi" shpk ka paraqitur kontratë bashkëpunimi me shoqërinë Gega Center GKG shpk me NIPT K66801001T për pikat në Cërrik, përkatësisht Malasenj dhe Gostimë. Në dokumentacionin e dorëzuar për pikat e mësipërme mungojnë dokumentet si me poshtë.

Pika Malasenj mungon

- Leje mjedisore të tipit B , lëshuar nga QKL,
- Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK),

Pika Gostimë mungon

- Leje mjedisore të tipit B, lëshuar nga QKL,
- Certifikatë të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)
- Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë në datën e hapjes së ofertave

OE "Olsi" shpk ka paraqitur kontratë bashkëpunimi me shoqërinë "Komjani" shpk me NIPT J86902809C për pikën në Gramsh, përkatësisht Lagjja Axhensia. Në dokumentacionin e dorëzuar për pikën e mësipërme mungojnë dokumentet si më poshtë.

- Leje mjedisore të tipit B, lëshuar nga QKL,
- Certifikatë të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)

Përsa më sipër OE OLSI Shpk nuk përmbush kriterin pasi stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve ku do të kryhet furnizimi, të cilët janë në marrëveshje me të tretë (kontrata furnizimi/bashkëpunimi), të lidhur për këtë qëllim me shoqëri të tjera, nuk përmbushin të gjitha kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, si dhe detyrimisht të jenë të pajisura me Sistem Elektronik. Kriteri konsiderohet i papërmbushur.

2.3.6 Bazuar në VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 "Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshëm", Operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit, të kryhet me kartë elektronike.

Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve, të kryhet nga vetë AK. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë

e afishimit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vetë Autoriteti Kontraktor.

Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës, përbën kusht për s'kualifikim.

Në lidhje me këtë kriter, OE Olsi shpk ka paraqitur dokumentacion mbi faqen e menaxhimit të karburanteve (webpage) për subjektin e tij. Për asnjë nga pikat e tjera të cilat janë me kontratë bashkëpunimi, nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion justifikues për furnizimin me karta elektronike. **Kriteri konsiderohet i pa përmbushur.**

OE Olsi shpk skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë KASTRATI shpk, me adresë: Durrës, Lagjja 14, Rruga: Tirana, pranë Gjykatës së Apelit Shkozet [*emri dhe adresa e ofertuesit fitues*], se oferta e paraqitur për:

Loti II: me vlerë totale 402,500 (katërqind e dy mijë e pesëqind) lek **pa TVSH**, me marzh fitimi 17 lekë, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha Lagjja: Brigada XVII Sulmuese, Rruga: Petraç Popa, Elbasan sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 3 diteve ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anulimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ADMINISTRATORI
Luan TABAKU**